

VENDIM
Nr. 744, datë 20.11.2019

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 661, DATË 8.10.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 310, DATË 21.5.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘SKELE-UJI I FTOHTË, BASHKIA VLORE’, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në tabelën me emërtimin “Lista e pasurive të paluajtshme, pronë private, që do të shpronësohen për interes publik, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘Skelë-Ujë i Ftohtë, Bashkia Vlorë (Zona I, Skelë-Shkolla e Marinës)”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 661, datë 8.10.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të dhënat për numrin rendor 56 bëhen sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Vlera shtesë, prej 5 403 681 (pesë milionë e katërqind e tre mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e një) lekësh, e kësaj pasurie, i shtohet vlerës së përgjithshme të vendimit nr. 661 dhe do të përballohet nga buxheti i vitit 2019, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në programin “Planifikimi urban”.

3. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, do të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Vlorë dhe Bashkia Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lista e pasurisë së paluajtshme pronë private që do të shpronësohet për interes publik, e cila preket nga ndërtimi i segmentit rrugor “Skelë-Ujë i Ftohtë, Bashkia Vlorë (Zona I, Skelë - Shkolla e Marinës)”

Nr. rend. në VKM-në nr. 661/2014	ZK	Nr. pasurisë	Emër, Mbiemër	Lloji i pasurisë, referuar kartelës	Sipërfaqja totale e ndërtësës	Çmimi i vlerësimit të objektit, lekë/m ²	Vlera për sip. e objektit që do të shpronësohet në lekë	Shënime
56	8602	31/183-ND	Luan Fetahu	Ndërtesë	187 m ²	54,253.83	10,145,466.21	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendim nr. 0/121 akti, datë regj. 21.11.2014 dhe vendimin nr. 268, datë 2.3.2015, ka vendosur: ndryshimin e VKM-së nr. 661, datë 8.10.2014, “Për disa ndryshime në VKM-në nr. 310, datë 21.5.2014, ‘Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Skelë-Ujë i Ftohtë”, Bashkia Vlorë, në lidhje me subjektin e shpronësuar z. Luan Fetahu, duke saktësuar sipërfaqen ndërtimore të prekur nga projekti nga 87.4 m ² , në 187 m ² . Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë me vendimin nr. 2344, datë 12.6.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Vlorë nr. 268, datë 2.3.2015. Është likuiduar vlera për 87.4 m ² sipas VKM-së nr. 661/2014.
Vlera							10,145,466.21	